


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KALENDARI ARTISITIK MAJ 2023



“SHTËPIAKË TË DËSHPËRUAR”

Ju fton për të festuar shfaqjen e 50, në Tiranë:

Data: 02, 04, 06. 05. 2023

Ora: 19:00

Vendi: Salla “Central 400”, ArTur-
bina

Komedia që mban rekord të qe-
shurash & me të gjitha biletat e shi-
tura, në çdo qytet ku ka udhëtuar, Durrës, Fier, Elbasan, Gjirokastër, Berat & Tiranë...

ÇMIMI I BILETËS: 700 LEKË

TEL: 04 222 3022 | 068 2000 650

ORARI I BILETARISË:

09:00-13:00 & 16:00-19:00

(E hëna ditë pushimi)



“CERTIFIKATA E MARTESËS”

Regjisore: Driada Dervishi

Data: 03, 05, 07. 05. 2023

Ora: 19:00

Vendi: Salla “Central 400”, ArTurbina

Pas 30 vitesh bashkëjetesë, çifti Meleku kujtohen që nuk dinë ku është çertifikata e martesës. A varet realisht martesë nga një certifikatë? Dhe më e rëndësishmja, pas 30 vitesh a do të martoheshë sërish me burrin a gruan që ke? Një komedi sociale e filozofike.

A varet martesë nga një certifikatë?

Me aktorët: Gentian Zenelaj, Olta Daku, Vlera Pylla, Mimoza Marjanaku, Xhuliano

Brisku, Amri Hasanlliu

Përkthyes : Artur Lena

Kompozitor : Endri Sina

Skenograf : Kiço Çala

Kostumografe : Ermela Marku

ÇMIMI I BILETËS: 700LEKË

TEL: 068 2000 650

ORARI I BILETARISË:

09:00-13:00 & 16:00-19:00



“GADJO”

Dramë nga Jeton Neziraj

Data: 04-07.05.2023

Ora: 20.00

Vendi: ArTurbina – salla 150

Organizuar nga: TKEKS dhe Qendra Multimedia

Regjia: Blerta Neziraj

Aktorë: Edona Reshitaj, Juli Emiri, Verona Koxha, Rafael Hoxhaj, Blend Sadiku

Kompozitor: Jindrich Cizek

Kostumograf: Blagoj Micevski

Koncepti vizual dhe skena: Mentor Berisha

Realizimi i skenografisë: Beqo Nanaj

Dritat: Yann Perregaux, Mursel Bekteshi

Teknik i dritave dhe ndriçimit: Taulant Kotorri

Në vitin 2019, në Kosovë u regjistrua

seri sulmesh fizike mbi një grua rome. Ajo ishte një refugjate që para disa javësh ishte kthyer dhunshëm nga Belgjika në Kosovë dhe tani po përpqej të përshtatej në shoqërinë dhe mjedisin e ri. Disa ditë pas kthimit, ndërkohë që ishte larguar nga qendra e refugjatëve në Podujevë, një media lokale kishte botuar një lajm të rremë për “një burrë me pamje të një gruaje, që rrëmbente fëmijët në Kosovë”. Shpejt, lajmin e paverifikuar e kishin shpërndarë edhe medie të tjera në Kosovë dhe në Shqipëri. Si rezultat, gruaja rome u sulmua dhe u rrah brutalisht nga grupe të rinjsh në disa qytete.

Drama “Gadjo” (një term që romët e përdorin për joromët) synon të nxisë debat mbi racizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm të rinjtë, por po ashtu synon të hulumtojë dhe analizojë këtë shekull të mosdijes dhe intolerancës që nxitet e promovohet nga mediet e papërgjegjshme, në një mjedis ku tregu medial është kaotik dhe i pakontrolluar dhe ku nevoja për “klikime” është shndërruar në qëllim sipëror. “Gadjo” nxit dhe konfronton shoqëritë tona mbi romët, mitet mbi ta dhe pozitën e tyre në shoqëritë tona, ku racizmi e përbuzja janë të ngulitura thellë në vetëdijen tonë. “Gadjo” është një dramë për krejt këta të rinj e të reja, që me kurajë e vendosmëri po e përqafojnë këtë shekull të dhunës e mosdurimit, për të cilin kemi kontribuar të gjithë ne, por më së shumti, mediet dhe shkollat tona. Demonët e dhunës janë ringjallur dhe po kalërojnë shesheve të qyteteve tona...



“ARTURO UI”

Vendi: Dramë

09-11.05.2023

Ora: 19:00

Vendi: Salla “Central 400” ArTurbina, Tiranë

Organizuar nga: Teatri Kombëtar i Bitola-s, Republika e Maqedonisë së Veriut

Autor: Bertolt Brecht

Regjisor: Qëndrim Rijani

Kronika e ngritjes së Arturo Ui, një

mafioz fiktiv i viteve 1930 në Çikago, dhe përpjekjet e tij për të kontrolluar tregun e lulëkrës duke asgjësuar në mënyrë të pamëshirshme opozitën. Shfaqja është një alegori satirike e ngritjes së Adolf Hitlerit dhe Partisë Naziste në Gjermani para Luftës së Dytë Botërore.



“UNË JAM VETË GRUA”

Data: 16.05.2023

Ora: 20:00

Vendi: ArTurbina

Organizuar nga: Aleanca LGBT

Shfaqja me regji të Kushtrim Koliqit, në të cilën Adrian Morina si aktori i vetëm në skenë luan më shumë se 30 personazhe, na sjell një histori të një jete tejet të vështirë të një personi transgjinior gjerman – Charlotte von Mahlsdorf, e cila i ka mbi-jetuar regjimit nazist dhe Stasi-t.

Shfaqja fituese e çmimit “Pulitzer” dhe e çmimit “Toni” është shfaqje që bazohet në bisedat dhe intervistat e Doug Wright me transgjinioren gjermane, njëherësh treg-taren e antikuareve Charlotte von Mahlsdorf, si dhe në autobiografinë e Charlotte të vitit 1992, të titulluar po ashtu “Unë jam vetë grua”.

Për portretizimin e plotë të Charlotte, gjatë periudhës naziste dhe regjimit komunist pasues, ndërsa jetonte haptazi si transgjiniore, shfaqja kërkon që aktori i saj i vetëm të luajë rreth 30 role të ndryshme. Titulli i shfaqjes ka dalë nga një anekdotë që e tregon Charlotte: kur ajo ishte dyzet vjeç, nëna e saj duke mos pasur asnjë ide, i tha “Boll luajte dhe u pispillose. Je bërë burrë tani. Kur ke ndër mend të gjesh një grua dhe të martohesh?”. Kësaj pyetjeje Charlotte iu përgjigj: “Kurrë, mamaka. Unë jam vetë grua”.

“ËNDRRA IME, RINA”

Komedi romantike

Data: 19-21.05.2023

Ora: 19:00

Vendi: Teatri Kombëtar, salla “Central 400”, ArTurbina, Tiranë

Autor: Pëllumb Kulla

Regjisor: Spiro Duni

Produksion i Teatrit Kombëtar

Një regjisor teatri në prag pensioni dhe në prag divorci me gruan e tij dhe situatat e ndryshme që krijohen nga ndërveprimet e tij me familjen, fëmijët dhe personazhet e ndryshme që vijnë në shtëpinë e tij për të kërkuar ndihmë profesionale. Një vështrim komik mbi familjen, problemet e saj dhe dukuritë sociale bashkëkohore.

“TANI KENI SY PËR TA PARË”

Data: 11-13, 18-21, 25- 28.05.2023

Ora: 20:00

Vendi: TKEKS, ArTurbina

“Tani keni sy për ta parë”, sjell në vëmendje mënyrat e ndryshme se si figura e gruas trajtohet si e padukshme në kulturën tonë. Ato kërcejnë, këndojnë dhe tregojnë metamorfozën mentale dhe fizike

që gruaja përjeton në katër stinët e vitit. Zëri i gruas është sfidues. Pyetja e grave në skenë është e thjeshtë: Si dhe pse e lejojmë që fuqia jonë të zhduket pa luftuar? Gjashtë gra, të cilat rrëfejnë historinë e tyre: Joanne sjell në vëmendje sfidat e gazetareve gra, Flo nëna e dy fëmijë tregon përpjekjet e saj për të ndërtuar një karrierë si artiste, Dez e gjendur në një periudhë tranzit në jetën e saj duhet të marrë një vendim, Kate një mikrobiologe e pasionuar merr vesh që ka mbetur shtatzënë dhe gjendet përballë vendimit ta mbajë fëmijën apo të vazhdojë me studimin e saj në Brazil për të realizuar një reportazh që do të mbajë emrin e saj, Jenie përballlet me depresionin pas lindjes, por dhe me dashurinë e madhe që ka për foshnjën e saj, Darya e lirë nga patriarkati, gati një figurë mitologjike në këtë pjesë, e cila në këtë pjesë ka rol vëzhgues dhe narrativ.



“TROKET FOLK”

Koncert

Data: 04.05.2023

Ora: 20:00

Vendi: Skena e TKOBAP

Koncert i solistëve të mirënjohur Armaldo Kllogjeri, Ylli Baka dhe Era Rusi, të cilët së bashku do të realizojnë një mbrëmje dedikuar muzikës popullore me artistët e Ansambllit Popullor.

“KONCERT RECITAL PIANISTIK”

Data: 12.05.2023

Ora: 19:00

Vendi: Holli koncertor i TKOBAP

Solisti Marin Gjollma do të realizojë një program të larmishëm solistik.



“GJERGJ KASTRIOTI – SKËNDERBEU, KRYEZOT I ARBËRIT”

Opera solemne

Vendi: 09.05.2023

Ora: 20:00

Vendi: Skena e TKOBAP

Data: 17.05.2023

Vendi: Prishtinë Kosovë

Kompozitor: Vaso Tole

Dirigjent: Sieva Borzak

Dirigjent kori TKOB: Dritan Lumshi

Dirigjent Kori FK: Hajrullah Syla

Vepra fituese e konkursit mbi krijimtarinë e re “Skënderbeu” nga Vaso Tole. Ky krijim vjen si një bashkëpunim mes TKOB-së dhe Filharmonisë së Kosovës, në nderim të figurës historike të Heroit Kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu.



“TINGUJT E LUFTËS SË PARË BOTËRORE”

Koncert solistik

Data: 19.05.2023

Vendi: Holli koncertor i TKOBAP

Organizuar nga: TKOBAP

Soliste në violinë: Abigeila Voshtina

Soliste në piano: Herta Cane

“DON QUIXOTE”

Ludwig Minkus

Balet Premierë

Data: 26-27, 29-30.05.2023

Ora: 20:00

Vendi: Skena e TKOBAP

Organizuar nga: TKOBAP

Don Quixote, një vepër klasike, e cila ka mbi 20 vjet që nuk interpretohet nga trupa artistike e TKOB-it. Kjo vepër vjen e interpretuar nga orkestra e Operës dhe Filarmonisë, trupa e baletit të TKOB në bashkëpunim me Shkollën Koreografike të Baletit Tiranë.

Koreografia e Marius Petipa dhe Alexander Gorsky, sipas variantit të Barachnikov.

Dirigjent: Jacopo Sipari di Pescasseroli

Koreograf: Giuseppe Picone.

Koncert pianistik solistik”

Data: 31.05.2023

Ora: 20:00

Vendi: Skena e TKOBAP

Organizuar nga: TKOBAP

Peter Donohoe, një pianist me famë ndërkombëtare, vjen për herë të parë në Shqipëri për të realizuar një koncert virtuoz solistik në piano.



NOTRE DAME DE PARIS

Musical

Për here të parë në Tiranë

Data: 28 maj

Vendi: Air Albania

Një ndër historitë më mbresëlënëse të të gjithë kohërave vjen në Tiranë në një shfaqje të jashtëzakonshme. Trupa e parë e produksionit gjigand zbarkon në kryeqytetin shqiptar për t'i dhuruar publikut një eksperiencë të papërsëritshme.

Shfaqja muzikore ikonike që bën bashkë 65 artistë nga e gjithë bota sjell në skenë copëzat e mozaikut të një kujtese kolektive. Drama e Kuazimodos dhe ciganes Esmeralda, bazuar në veprën e shkrimtarit Viktor Hygo prej 25 vitesh tashmë lë gojëhapur spektatorët në katër krahët e globit.

Nën muzikën e Riccardo Cocciante dhe spektaklin e Luc Plamondon, "Notre Dame de Paris" është gati të mbajë peng për së paku 150 minuta zemrën e secilit të pranishëm në stadiumin Air Albania më datë 28 maj.

Historiku

Notre-Dame de Paris është një shfaqje muzikore e cila e bëri debutimin e saj të parë më 16 shtator 1998 në Paris.

Historia bazohet në romanin

Notre-Dame de Paris (i njohur në anglisht si The Hunchback of Notre-Dame) nga shkrimtari francez Victor Hugo. Muzika u kompozua nga Riccardo Cocciante ndërsa teksti mban vulën e Luc Plamondon.

Që nga debutimi i parë shfaqja është luajtur në Belgjikë, Kanada, Kinë, Francë, Itali, Japoni, Liban, Luksemburg, Poloni, Rusi, Singapor, Korenë e Jugut, Spanjë, Zvicër, Tajvan, Turqi, Mbretërinë e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara, dhe është përkthyer në dhjetë gjuhë. Disa këngë nga spektakli, si "Vivre", "Belle" dhe "Le temps des cathédrales", janë publikuar si single duke korrur kështu një sukses të jashtëzakonshëm.

Notre-Dame de Paris, sipas Librit të Rekordeve Guinness, është shfaqja më e suksesshme ndonjëherë në vitin e parë të debutimit të saj.

Në Tiranë

Produksioni është menduar t'i ofrojë të gjithë spektatorëve që do të jenë të pranishëm një përjetim unik, duke i mundësuar atyre që ta shohin njësoj nga secili skaj i stadiumit, të titruar në ekranet mbështetës mjeshtërisht në gjuhën shqipe.

Biletat mund të blihen në formatin digjital në t- ticket. al si dhe në të gjitha pikat e autorizuara të shitjes në terren.

Shfaqja do të zërë vend për herë të parë në rajon në Tiranë në Stadiumin "Air Albania" më datë 28 maj me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës dhe Bashkisë Tiranë.



“SAFET E GJYLZADE DOKLE”

Vendi: Muzeu Kombëtar i Fotografisë “Marubi”

Kurator: Lek M. Gjeloshi

Muzeu “Marubi” prezanton ekspozitën personale të fotografëve Safet e Gjylzade Dokle, kuruar nga Lek M. Gjeloshi. Aktiviteti fotografik i bashkëshortëve Safet e Gjylzade Dokle u zhvillua në Borje të rrethit të

Kukësit e më gjerë, duke përshkruar një hark kohor 40 vjeçar, nga vitet ’30 deri në fillim të viteve ’70. Në koleksionin e tyre fotografik dokumentohet historia politike, jeta shoqërore, ritualet e ndryshme dhe aspektet tradicionale të Shqipërisë Verilindore të asaj kohe.

Ky koleksion, i cili përbëhet nga rreth njëzet mijë negativë, është më i madhi i dhuruar mbas viteve ’90 në arkivin e Muzeut Kombëtar të Fotografisë “Marubi”.

“SILVER LINING”

Data: 30.03-15.05.2023

Vendi: Bazament Art Space

Silva Agostini / Anna Ehrenstein / Lek M. Gjeloshi / Genti

Korini/ Irgin Sena / Driant Zeneli

Ekspozita “Silver Lining” bën bashkë disa nga zërat më interesantë të artistëve shqiptarë në fushën e filmit dhe videos. Aktiviteti përmbledh një seri videosh të realizuara nga artistët me të cilët “Bazament” ka bashkëpunuar përgjatë një eksperience 5-vjeçare. Qëllimi i këtyre videove është të rrëfejë rolin që ka arti në modelimin e hapësirës kulturore dhe sociopolitike.

PËRTEJ KUFIRIT DHE PORTAVE

(pasdite e përjetshme)

ARTAN PEQINI

Data: 03- 21.05.2023

Vendi: Galeria FAB, Universiteti i Arteve, Tiranë

Kuruar nga Najada Hamza

Në udhëtim,.. përsëri

Është cikli i tij i dytë piktorik, ai i një pasditeje të “përhershme”, ku dallohen përsëri po ato personazhe të njohura, të paqta e emblematisht. Ato përvihen aty në gjirin e natyrës, bashkë, si një grup i hedhur në një realitet fantastik, zbuluar papritur në oborrin e pasmë të shtëpisë. Në harmoni, rreth e përçark, ashtu të projektuar pothuajse gjithnjë në plan të dytë, ato shkrihen në tisin kromatik, ndriçuar fort nga drita e pasdites. Me çanta turistësh, rroba banje, a mbi motor, shpërndahen kudo, mes relikeve, natyrës, apo teksa notojnë elegantë në sipërfaqen e një lumi të papritur. Siç thoshte Prusti “Udhëtimi i vërtetë nuk konsiston në kërkimin e peizazheve të reja, por në të pasurit e një optike të re”. Ky udhëtim i ri duket se synon pikërisht këtë. Të pasurit e një optike të re. Bashkë me të kërkohet stimulimi i një kredhjeje në një realitet tjetër për të stimuluar kështu një dialog të ri, ndryshe, sa me veten aq dhe me natyrën.

TRASHËGIMIA INDUSTRIALE, NJË BURIM I 'BRISHTË'

Ekspozitë fotografike


Data: 4 maj 2023

Ora: 18:00

Vendi: Universiteti Politeknik i Tiranës,
Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës,
Sheshi "Nënë Tereza"

Organizuar nga: Instituti Italian i Kulturës dhe Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës
Projekti i kësaj ekspozite lindi në kuadrin e një bashkëpunimi dypalësh mes CNR (Këshilli Kombëtar Italian i Kërkimit) dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë në bashkëpunim me AKKSHI-n (Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit). Në veçanti ndërmjet Institutit të Shkencave të Trashëgimisë Kulturore (CNR ISPC) dhe Universitetit Politeknik të Tiranës - Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, me temën "Trashëgimia industriale: një burim 'i brishtë' që duhet të përmirësohet - nga njohuria te ripërdorimi i përshtatshëm dhe i qëndrueshëm".

Ekspozita synon të tregojë shembuj të zonave industriale të ndërtuara në gjysmën e parë të viteve '900, një moment historik në të cilin marrëdhëniet midis Italisë dhe Shqipërisë u konsoliduan dhe patën një shtysë të re duke filluar nga viti 1990. Në fakt, daton në vitin 1924 nënshkrimi në Romë i një "traktati të tregtisë dhe lundrimit" dhe një "marrëveshje themelimi", dhe nis prej vitit 1925 një zhvillim vendimtar i marrëdhënieve ekonomike midis dy shteteve, e rregulluar nga dy marrëveshje, e para e cila i jepte "Ferrovie dello Stato Italiane - Hekurudhat e Shtetit Italian" një sipërfaqe prej 47,213 hektarësh për kërkimin dhe nxjerrjen e naftës, e dyta në të cilën "Gruppo Finanziario Italiano - Grupi Financiar Italian" mori përsipër krijimin e "Bankës Kombëtare të Shqipërisë" dhe "Shoqërisë për Zhvillimin Ekonomik të Shqipëria" (Svea). Me këto, Italia shfaq synimin e saj për të sjellë në Shqipëri kontributin e përvojës, nismës dhe kapitalit të saj për të mbështetur Shqipërinë në rrugën e progresit ekonomik, nëpërmjet krijimit të bazave thelbësore për vlerësimin e burimeve të saj të pazbuluara.



“SPAÇI NË ARKIVA- 50 VJET NGA REVOLTA”

Data: 04.05. 2023

Ora: 11.00

Vendi: Salla “Musine Kokalari” e institucionit, Autoriteti për Informim mbi Dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit

Organizuar nga: Autoriteti për Informim mbi Dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit
Ekspozohen për herë të parë dokumente të arkivit të ish-Sigurimit të Shtetit, mbi revoltën dhe dosjet hetimore – gjyqësore të pesë grupeve që u ridënuan pas saj; paraqitet një studim me statistika dhe fakte mbi numrin e personave të burgosur në Spaç, flitet për veçorinë e dëshmime të mbledhura të të mbijetuarve të burgut dhe revoltës së Spaçit, ndërkohë që ekspertë të njohur të fushës rrëfejnë për kushtet e punës dhe prodhimin, eksportin dhe punën e detyruar në Spaç.

Aktiviteti mbahet në kuadër të ditës kombëtare të drejtësisë dhe synon krijë kushte dhe premisa për zhvillimin e analizën dhe debatin profesional juridik mbi zbatimin e ligjeve të kohës si: perspektiva e të drejtave të njeriut, liria e ndërgjegjes dhe lëvizjes, procesi i (pa)drejtë penal, shkelja e dispozitave kushtetuese për pagesën e pabarabartë të punës etj, dukuri që hasen në studimin e Spaçit, si burg politik e kamp pune i detyruar.

Të ftuar studiues, partnerë, ekspertë të punës dhe prodhimin në Spaç si dhe ish-të dënuar në këtë burg.

FASHION PANORAMA – THE ITALIAN NEW WAVE

Data: 8.05 – 2.06.2023

Ora: e hënë-e premte: 09:30-14:00 / 17:30-20:30; e shtunë: 17:30-20:30

Vendi: COD - Centre for Openness and Dialogue

Organizuar nga: Instituti Italian i Kulturës dhe COD

Fashion Panorama – The Italian New Wave është një projekt i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar, me kurator Vogue Italia. Ekspozita lindi me synimin për t’i dhënë zë dhe shikueshmëri gjeneratave të reja të stilistëve dhe stilistëve italianë, duke përçuar gjerësisht vizionin dhe punën e tyre.



Synimi i ekspozitës është të rrëfejë modën bashkëkohore italiane përmes vizionit dhe punës së 10 stilistëve - ACT N°1, Gisèle, Cormio, Lessico familiare, Magliano, Marco Rambaldi, Medea, Panconesi, Niccolò Pasqualetti, SSHEENA - të cilët, përkrah ripërpunimit të traditave artizanale në formë rishtarë dhe me gjuhë e metoda novatore, kanë mundur të ruajnë një marrëdhënie të fortë dhe të integruar me industrinë e tjera të lidhura me kulturën dhe krijimtarinë italiane, si dhe të trajtojnë në mënyrë origjinale aspirata dhe tema të dashura për shoqërinë bashkëkohore.

Fashion Panorama – The Italian New Wave përmban një ekspozitë fotografish, të krijuara enkas për këtë projekt, si dhe imazhe arkivore, të shoqëruara me materiale audio-vizuale, kushtuar punës së 10 talenteve të përfshirë.

Projekti është pjesë e një game më të gjerë nismash origjinale të promovimit të integruar, të promovuara nga Ministria e Punëve të Jashtme, për të projektuar jashtë vendit një imazh organik, të shumanshëm dhe aktual të Sistema Italia. Fashion Panorama – The Italian New Wave thekson se si sektori i modës luan një rol kyç në vendin tonë, është një shembull i të qenit dhe sjelljes si “italian”, si dhe një burim frymëzimi për sistemin tonë prodhues dhe krijues.

TIRANA INTERNATIONAL WATERCOLOR BIENNIAL

Bienalja Ndërkombëtare e Akuarelit, edicioni 5.

Data: 04-14.05.2023

Vendi: Galeria e Arteve të Tiranës dhe Muzeu Historik Kombëtar

Organizuar nga: International Watercolor Society – IWS Albania

Një eveniment që vjen me një tjetër koncept kuratorial dhe me shumë ekspozita interesante.

Bienalja do të sjellë së bashku 15 Mjeshtër të Mëdhenj Ndërkombëtarë të Akuarelit, në një ekspozitë të titulluar “Sms, Super Master Show”.

Veprat e mjeshtërve të mëdhenj do të ekspozohen në Galerinë e Arteve të Tiranës dhe në Muzeun Historik Kombëtar, bërthamën e kulturës dhe trashëgimisë së kryeqytetit shqiptar, nga data 04 – 14 maj 2023.

“RIN VIZART – TIRANA INTERNATIONAL CONTEMPORARY FESTIVAL”

Data: 04-14.05.2023

Vendi: Salla e ekspozitave në katin e dytë të Muzeut Historik Kombëtar

Organizuar nga: International Watercolor Society – IWS Albania

Rinart filloi udhëtimin në 2015 dhe rishtas nga 2022 edhe të rinjtë shqiptarë gjetën veten mrekullisht në këtë lloj aktiviteti. Këtë vit organizohet ekspozitë me pjesëmarrjen e të rinjve nga bota dhe kryesisht Shqipëria e Kosova, ku bashkë me 15 mjeshtër të mëdhenj nga bota do të ekspozojnë punimet e tyre në vaj, akuael, skulpturë, instalacion, akrilik, vizatim, grafikë, video art, digjital print etj.

DITA NDËRKOMBËTARE E MUZEVE 2023

Data: 18.05.2023

Ora: 11:00

Organizuar nga: Muzeu Historik Kombëtar

Salla “Kostandin Shpataraku”, Muzeu Historik Kombëtar

Tryezë e rrumbullakët me temën e këtij viti “Muzetë, qëndrueshmëria dhe mirëqenia”.

Muzetë janë kontribuesit kryesorë për mirëqenien dhe zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve tona.

‘EKRANI I ARTIT’

Festivali i filmave eksperimentalë dhe videoartit

Data: 31 maj - 4 qershor

Vendi: Shkodër

Organizuar nga: Fondacioni ‘Art House’

Fondacioni ‘Art House’ i themeluar nga Adrian e Melisa Paci, organizon edicionin VI të festivalit ‘Ekran i Artit’ në Shkodër (31 maj - 4 qershor), një festival i filmave eksperimentalë dhe videoartit. Edhe ky edicion do të vijë para publikut i pasur me filma, ekspozita, takime, workshope dhe performanca muzikore.

Për herë të parë festivali do të ketë një ditë fokusi të dedikuar filmit dhe videoartit në Suedi. Gjithashtu, aktiviteti rikthehet në hapësirën e ‘Kinema Millenium’, vendin nga ku nisi udhëtimin e tij gjashtë vite më parë.

‘Ekran i Artit’ do të vazhdojë me rolin e tij të pazëvendësueshëm si pikë takimi për artistë të rinj shqiptarë dhe kuratorë e profesionistë nga bota përmes prezantimit të portofolave artistikë, si dhe me aktivitetin edukativ dhe punëtorinë me fëmijë.

‘Art House’ ka kënaqësinë të prezantojë drejtorin artistik të këtij edicioni, kuratorin dhe kritikun e mirënjohur Edi Muka, i cili ka shprehur entuziazmin e tij për ftesën dhe angazhimin në ‘Ekran i Artit’ 2023.

EKSPOZITË “NGA 1989 DERI NË FUND”

Data: 29, 30.05.2023

Ora: 12:00

Vendi: Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia me Gjethë

Ekspozitë nga Qendra e Muzeve të Bashkisë së Bukureshtit

“NËNA”

Grazia Deledda

Data: 02. 05. 2023

Ora: 18:00


Vendi: Biblioteka e IIC, Tiranw

Organizuar nga: Instituti Italian i Kulturës, Departamenti i gjuhës italiane pranë Fakultetit të Gjuhëve të Huaja Hyrja e lirë

Kuruar nga: Prof. Klodeta Dibra

Prezantimi do të çelet nga prof. Irena Lama, docente e letërsisë italiane pranë Fakultetit të Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës, e cila do të ilustrojë figurën e Grazia Deleddës në skenën letrare italiane. Grazia Deledda, fituese e çmimit Nobel për letërsinë, ka shkruar romane dhe tregime të shkurtra me frymë etike, ku përshkruhet jeta e vështirë e përditshme e bashkëfshatarëve sardë. Asgjë nuk mund të krahasohet me marrëdhënien e ngushtë që krijohet mes nënës dhe fëmijës dhe pikërisht mbi këtë bazë të fortë Grazia Deledda ndërton një histori lotësh, vuajtjesh e pasioni. “Nëna” është një roman i shkurtër, me një ngjarje të përmbledhur, por intensiteti i përmbajtjes është mjaft i fuqishëm. Deledda ndien nevojën për të nxjerrë në dritë forcat embrionale më të vërteta dhe natyrale të qenies njerëzore, qofshin ato të krijuara nga instinkti apo të formuara nga doket dhe zakonet e tokës që i ka krijuar. Romani i botuar nga shtëpia botuese Ombra GVG, është përkthyer falë kontributit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar.

Gjuha e eventit: italisht dhe shqip



“NETËT KORÇARE TË POEZISË”

Festival Ndërkombëtar

Data: 06, 07.05.2023

Ora: 11:00

Vendi: Korçë

Organizuar nga: Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit

Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit në bashkëpunim me Bibliotekën Publike dhe me mbështetjen e Bashkisë Korçë do të organizojnë një aktivitet letrar në kuadër të Festivalit Ndërkombëtar “Netët korçare të poezisë”.

Poetë shqiptarë nga e gjithë Shqipëria do të bëhen bashkë në një mbrëmje poetike, ku nuk do të mungojnë leximet dhe interpretime nga poezia e tyre.

SALLONI NDËRKOMBËTAR I LIBRIT, TORINO, 2023

Shqipëria, “paese ospite”

Data: 18-22. 05. 2023

Vendi: Torino

Salloni Ndërkombëtar i Torinos është një nga ngjarjet më të rëndësishme të pranverës në industrinë e librit, duke bërë bashkë autorë, botues, media nga e gjithë Italia dhe bota. Panairi do të mbahet nga data 18-22 maj 2023.

Tema e këtij viti është “Përmes Pasqyrës”

“ÇMIMI ‘LUMO SKËNDO’”

Data: 25.05.2023

Ora: 12:00

Vendi: QKLL

Organizuar nga: Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit

Juria e Çmimit “Lumo Skëndo” do të bëjë publik emrin e fituesit të çmimit të këtij edicioni, si edhe motivacionin e dhënies së çmimit.

“SHQIPËRIA LEXON! TAKIM ME LEXUES NË TROPOJË”

Data: 26.05.2023

Ora: 11:00

Vendi: Tropojë

Organizuar nga: Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit

Në kuadër të fushatës së leximit “Shqipëria lexon”, QKLL do të organizojë një takim me të rinjtë e qytetit të Tropojës. Gjatë takimit do të ketë lexime e interpretime nga letërsia shqipe, si edhe diskutime mbi rolin e leximit për një shoqëri më të mirë etj.

SHPALLJA E FITUESVE TË “FONDIT PËR PËRKTHIMIN LETRAR NGA GJUHA SHQIPE NË GJUHË TË HUAJ”

Data: 31.05.2023

Ora: 12:00

Vendi: QKLL

Organizuar nga: Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit

Juria e Çmimit “Fondit për përkthimin letrar nga gjuha shqipe në gjuhë të huaj” do të bëjë publik 6 fituesit e këtij fondi.

Këtë vit në thirrjes për mbështetje financiare për “Fondin e përkthimit letrar nga gjuha shqipe në gjuhë të huaj” iu përgjigjën 24 aplikime nga gjuhët: anglisht, italisht, greqisht, çekisht, maqedonisht, arabisht, indishte, polonisht, gjermanisht e frëngjisht.

“HIRUSHJA”

Teatri i kukullave

Përralla e njohur vjen në një shfaqje teatrale për fëmijë.

Data: 06, 07.05.2023

Ora: 10:30, 11:30


Vendi: Salla “Tonin Harapi”, Liceu artistik” Jordan Misja”

Regjia: Klajd Ymeri

Aktorët: Esmeralda Kame, Aleksandër Grami, Ermonela

Alikaj, Ilija Kaçi, Albana Koçaj.

Kohëzgjatja 45 min.



LOJA “E KA KUSH E KA-XHUBLETA”

Muzeu Historik Kombëtar

Shfaqja synon të përcjellë njohuritë mbi trashëgiminë tonë kulturore me broshurën “Xhubleta”.

Data: 10.05.2023

Ora: 10:30

Vendi: Shkolla 9-vjeçare “Jeronim de Rada”



“PRINCESHAT DHE BIZELJA MAG-JIKE”

Teatri i kukullave

Data: 10.05.2023

Ora: 11:00

Vendi: Dibër

Data: 11.05.2023

Ora: 11:00

Vendi: Peshkopi

Shfaqje teatrale me kukulla, pjesëmarrje në festival, Dibër e Madhe.

Regjia: Xhuliano Brisku

Aktorët: Jorida Meta, Madi Selimi, Elidon Alika.

Kohëzgjatja 40 min.

“BORËBARDHA DHE SHTATË XHUXHAT”

Data: 03.05.2023

Ora: 17:00

Vendi: Teatri Skampa, Elbasan
Shfaqje teatrale me kukulla. Pjesëmarrje në festivalin Ndërkombëtar të Kukullave, Elbasan.


Shfaqje teatrale me kukulla.

Regjia: Aldjon Matarangasi.

Aktorët: Jorida Meta.

Kohëzgjatja 35 min.

Teatri i kukullave



“MAÇOKU ME ÇIZME”

Shfaqje teatrale me kukulla

Data: 13, 14. 05.2023

Ora: 10:30; 11:30

Vendi: Salla “Tonin Harapi”, Liceu artistik” Jordan Misja”

Regjia: Paolo Comentale.

Aktorët: Elidon Alike, Jorida Meta, Albana Koçaj, Ermonela Alikaj, Aleksander Grami, Madi Selimi, Flori Kokona.

Kohëzgjatja 35 min.

“DITA NDËRKOMBËTARE E MUZEVE”.

Data: 18.05.2023

Ora: 11:00

Vendi: Muzeu Historik Kombëtar

Tema për vitin 2023, e përcaktuar nga ICOM është: “Muzetë, qëndrueshmëria dhe mirëqenia”.

Muzeu Historik Kombëtar kontribuon për mirëqenien dhe zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve tona.

Në kuadër të kësaj dite do të organizohet një aktivitet në bashkëpunim me shkollën e mesme “Sami Frashëri”, në Tiranë.

Objektivi kryesor i këtij aktiviteti është jeta në Tokë, promovimi i qëndrueshëm i ekosistemeve tokësore. Objektivi i dytë është promovimi i mirëqenies për të gjithë të rinjtë, veçanërisht në lidhje me shëndetin mendor dhe izolimin social. Për këtë arsye, aktiviteti do të shoqërohet dhe me argëtimin nëpërmjet lojës në muze.

EKSPOZITË “MBRESA”

Data: 18-26.05.2023

Ora: 11:00

Vendi: Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia me Gjethe”

Ekspozitë me punimet artistike të nxënësve pjesëmarrës në programin “Mbresa”

FINALIZIMI I PROJEKTIT ARTISTIK “MBRESA”

Ceremonia e ndarjes së çmimeve”.

Data: 23.05.2023

Ora: 17:00

Vendi: Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia me Gjethe”

Ceremonia finale e edicionit “Mbresa”, ku do të ndahen çmimet fituese.

“EKSPOZITË SKULPTURE”

Data: 19.05.2023

Ora: 17:00

Vendi: Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë

Ekspozitë skulpture me punime në skulpturë nga fëmijët e kursit të skulpturës të Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë.

“GJIRAFAT NUK VALLËZOJNË”

Shfaqje për fëmijë

Datat: 13-14, 20-21, 27-28.05.2023

Ora: 10:30

Vendi: TKEKS, Arturbina

“Gjirafat nuk vallëzojnë” ka në qendër Geraldin, një gjirafë që nuk dinte të kërcente. Geraldin ka katër këmbë të majta, gjunjët i mban gjithmonë përkulur dhe këmbët i ka të ngurta. Gjatë festës së përvitshme të xhunglës, të gjitha kafshët interpretuan shumë bukur dhe u tallën me Geraldin e gjorë, duke qeshur dhe duke e nxjerrë nga pista e kërcimit. Geraldin u mërzi, por kur po largohej ai takon një gjinkallë. Kjo krijesë e vogël dhe e mençur i jep një këshillë, duke i thënë se “Ndonjëherë kur je ndryshe, thjesht të duhet një këngë e ndryshme”. Duke dëgjuar tingujt e pemëve dhe erës, Geraldin fillon të lëvizë. Me muzikën e natyrës përreth tij, ai lëkundet dhe vallëzon me delikatesë. Falë ndihmës së gjinkallës, Geraldin mëson të vallëzojë dhe i habiti të gjitha kafshët e xhunglës.

“ROSAKU I SHËMTUAR”

Data: 20, 21. 05.2023

Ora: 10:30 dhe 11:30

Vendi: Salla “Tonin Harapi”, Liceu artistik” Jordan Misja”

Shfaqje teatrale me kukulla.

Regjia: Paolo Comentale

Aktorët: Jorida Meta, Albana Koçaj, Ermonela Alikaj, Elidon Alikaj, Esmeralda Kame, Aleksandër Grami, Madi Selimi, Flori Kokona, Ilia Kaçi.

Kohëzgjatja 40 min..



“BORËBARDHA DHE SHTATË XHUXHAT”

Shfaqje teatrale me kukulla, pjesë e turit veror 2023.

Regjia: Aldjon Matarangasi. Aktorët: Jorida Meta. Kohëzgjatja 35 min.

Data 23.05.2023

Ora: 11:00 dhe 19:00

Vendi: Roskovec dhe Lushnjë

Data: 24.05.2023

Ora: 19:00

Vendi: Fier

“MUZEU IM”

Data: 25.05.2023

Ora: 11:30

Vendi: Muzeu Historik Kombëtar

Objektet e vjetra që ruajmë në shtëpi marrin vlera muzeale me kalimin e kohës. Historitë e tyre i tregojmë në muze.

OPERA PËR FËMIJË DHE FAMILJE

“Flauti Magjik”

Datat: 26.05.2023 -28.05.2023

Ora: 11:00

Vendi: Holli koncertor i TKOBAP

Organizuar: TKOBAP

Opera premierë për familjet dhe fëmijët në një version të shkurtuar. Një titull i cili për formën, muzikën dhe dramën e saj është një ndër veprat më të mira për të pasur një përjasje të parë me operën.

Kompozitor: W. A. Mozart

Regjisor: Ada Gurra

Skenograf- Kostumograf: Dea Bejleri

“ROZA DHE FATI”

Data: 26.05.2023

Ora: 11:00

Organizuar nga: Teatri i kukullave

Vendi: Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë

Data: 27-28.05.2023

Ora: 10:30; 11:30

Teatri “Aleksandër Moisiu”, Durrës

Shfaqje teatrale me kukulla, bazuar në përrallat e moçme shqiptare.

Regjia: Medi Gurra

Aktorët: Flori Kokona, Elidon Alike, Ilia Kaçi, Aleksandër Grami. Esmeralda Kame.

Kohëzgjatja 40 min.

“TK RIN ART 2023”

Data: 22.05.2023 deri 26.05.2023

Data: 29.05.2023 deri 31.05.2023

Vendi: Salla “Central 400” ArTurbina, Tiranë

Edicioni VI i Festivalit Teator për të Rinjtë, ku do të angazhohen 9 regjisorë të rinj, të cilët do të krijojnë 9 produksione me elementët/nxënësit më të mirë nga 9 gjimnaze të kryeqytetit. Aktiviteti funksionon në formë konkursi, ku në fund do të shpalen dhe fituesit në kategori të ndryshme, nga juria artistike, e përbërë nga aktorë profesionistë brenda strukturës së Teatrit Kombëtar.